

Afrim Shala*

AKTGJYKIMI SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Forma dhe përmbajtja e aktgjykimit është përcaktuar në radhë të parë në dispozitën ligjore të nenit 369 të KPP-së. Në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar se “Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin”. Kjo dispozitë ligjore përcakton strukturën e aktgjykimin dhe specifikon çështjen e njëjtësisë së aktgjykimit të përpiluar me shkrim me aktgjykimin e shpallur. Me aktgjykim, si vendimi më i rëndësishëm në procedurë penale, sipas rregullit zgjidhet çështja penale në mënyrë meritore.

Përndryshe, aktgjykimi është njëri nga tri format e vendimeve që merren nga gjykata gjatë procedurës penale, krahas aktvendimit dhe urdhrit. Sipas dispozitës ligjore të nenit 469 paragrafi 1 të KPP-së, në procedurën penale vendimet merren në formë të:

- 1) aktgjykimit,**
- 2) aktvendimit dhe**
- 3) urdhrit”.**

Vetëm gjykata mund ta marrë aktgjykimin, kurse aktvendimin mund ta marrë edhe prokurori i shtetit, ndërsa urdhrin mund marrin edhe organet e tjera publike që marrin pjesë në procedurë penale.¹

Siç do të shohim edhe më poshtë, aktgjykimi është vendim gjyqësor i cili merret dhe shpallet në emër të popullit dhe njëherit, përfaqëson zbatimin e kodit penal në një rast konkret. Nëpërmjet tij zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që është vërtetuar se kanë kryer ndonjë vepër penale.²

* Ky punim është përgatitur për pjesëmarrësit e trajnimit “Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore”, të organizuar nga Akademia e Drejtësisë, më datat 02-03 prill 2026.

¹ Neni 469 paragrafi 2 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, datë 17.08.2022 (në vijim: KPP).

² SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, Prishtinë, 2023, fq.78.

Aktgjykimi i formës së prerë e ka fuqinë e ligjit për çështjen konkrete penale që është zgjidhur me të dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë.³ Dhënia e aktgjykimit, pra është e drejtë ekskluzive e gjykatës. Me të bëhet formimi faktik dhe juridik i çështjes penale, ndërsa ai jepet pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.⁴

Në rastet kur i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga neni 242 paragrafi 2 të KPP-së, atëherë merr aktvendim për miratimin e pranimit të fajësisë dhe procedon me shqiptimin e dënimit, e cakton seancën sipas nenit 356 të këtij Kodi për të përcaktuar çështje që janë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit⁵ ose e pezullon shqiptimin e dënimit deri në përfundimin e bashkëpunimit nga i pandehuri me prokurorin e shtetit. Në këto situata, mandej merret aktgjykim pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe një aktgjykim i tillë bazohet mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe të miratuar nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues.⁶

Duke u bazuar në nenin 369 paragrafi 1 të KPP-së, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur nga gjykata.⁷ Pra, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me aktgjykimin të cilin e ka shpallur gjykata.

Gjithashtu, edhe aktgjykimi i shpallur nga gjykata duhet të jetë në përputhje, përkatësisht identik me dispozitivin e aktgjykimit të shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor.⁸

³ Vendimi përfundimtar i gjykatës është sinteza e gjykimit dhe përfaqëson zgjidhjen e çështjes në themel mbi bazën e provave të administruara në shqyrtim gjyqësor. Ai shpreh bindjen e gjyqtarëve për ekzistencën ose jo të faktit, për fajësinë e të pandehurit dhe për shkallën e rrezikshmërisë së tij shoqërore. Kjo bindje duhet të përputhet me kërkesat e ligjit penal, të atij material dhe procedural. Në bazë të nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, për marrjen e vendimit, gjykata përdorë vetëm provat që janë marrë ose janë verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. ISLAMI, HALIM; HOXHA, ARTAN; PANDA, ILIR: Procedura penale, Komentar, Tiranë, 2003, fq. 496.

⁴ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016, fq.387.

⁵ SHALA, AFRIM: Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike “*Opinio Juris*”, Prishtinë, 2016, fq. 1-8.

⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.78.

⁷ Shpalljen e aktgjykimit e rregullon neni 365 i KPP-së.

⁸ Neni 315 paragrafi 1 të KPP-së.

2. Pjesët përbërëse të aktgjykimit

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369 paragrafi 1 të KPP-së, aktgjykimi duhet të përfshinë:

- 1) **hyrjen,**
- 2) **dispozitivin** dhe
- 3) **arsyetimin.**

Gjithashtu, pjesë përbërëse e aktgjykimit duhet të jetë edhe *“Udhëzimi për të drejtën në ankesë”*.⁹

Udhëzimi për të drejtën në ankesë përmban këshilla juridike se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, nga palët dhe personat tjerë të autorizuar, sipas nenit 381 të KPP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes aktgjykimit. Ankesa duhet që t’i dorëzohet gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.

2.1. Pjesa hyrëse

Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit,¹⁰ emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, datën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.¹¹

⁹ Shih nenin 369 paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 473 paragrafi 3 të KPP-së.

¹⁰ Në Republikën e Shqipërisë, gjykatat i japin vendimet *“Në emër të Republikës”* (Neni 146 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 112 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë). Në Republikën e Kroacisë, aktgjykimi merret dhe shpallet *“Në emër të Republikës së Kroacisë”* (neni 117, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, si dhe neni 366 paragrafi 2 dhe neni 376 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë), kurse në Mbretërinë e Holandës, aktgjykimi merret *“Në emër të Mbretit”* (neni 554 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale).

¹¹ Neni 369 paragrafi 2 i KPP-së.

2.2. Dispozitivi i aktgjykimit

Dispozitivi i aktgjykimit përfshin: të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.

Sipas nenit 361 të KPP-së, me aktgjykim ose refuzohet akuza, ose i akuzuari lirohet nga akuza, ose shpallet fajtor. Kur akuza përfshin disa vepra penale, në aktgjykim shënohet nëse dhe për cilën veprë është refuzuar akuza, apo nëse dhe për cilën veprë i akuzuari lirohet ose shpallet fajtor. Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore ekzistojnë këto katër (4) forma të aktgjykimit :

- 1) **aktgjykim refuzues;**
- 2) **aktgjykim lirues;**
- 3) **aktgjykim fajësues dhe**
- 4) **variante të kombinuara të këtyre aktgjykimeve.**

Aktgjykimi fajësues është një nocion më i gjerë se sa aktgjykimi dënues, pasi që në vete ngërthen edhe aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, por që është liruar nga dënimi, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK-së.

“Të dhëna personale” përfshijnë informacionin personal si vijon: emrin, mbiemrin, emrin e qytetit të lindjes ose vendbanimit, funksionin publik të të pandehurit nëse ka dhe numrin personal. Kur numri personal nuk është në dispozicion, atëherë në vend të tij mund të përdoren data e lindjes, emri i njërit prind dhe vendlindja.

Të dhënat personale shpesh, ashtu siç kuptohet ky term nga ligjet tjera, mund të shtohen vetëm nëse është e nevojshme për të shpjeguar rrethanat kontekstuale të veprave penale.¹²

Është e rëndësishme që të theksohet se përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale të lartcekura, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.¹³

Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të KPP-së, ndërsa kur ai është liruar nga akuza

¹² Neni 369 paragrafi 12 i KPP-së.

¹³ Neni 369 paragrafi 13 i KPP-së.

ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përkrahimin e veprës për të cilën është akuzuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1. Veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;
2. Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;
3. Vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar;
4. Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike;
5. Taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi; dhe
6. Aktgjykimi gjithashtu duhet të theksojë nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose televizion.¹⁴

Nëse nuk është bërë kërkesë për seancën për caktimin e dënimit¹⁵ nga prokurori i shtetit, i akuzuari ose mbrojtësi i tij, gjykata në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor gjithashtu shënon:

1. Dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal ose lirim nga dënimi;
2. Vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit;
3. Urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli;
4. Kur i akuzuari dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.

Siç është theksuar edhe më lart, në nenin 369 paragrafi 4 të KPP-së është parashikuar se kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi, ndërsa, në nënparagrafin 11., paragrafi 1 të këtij neni është parashikuar se gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon veprën penale për të cilën shpallet

¹⁴ Neni 364 paragrafi 1 i KPP-së.

¹⁵ Seanca për caktimin e dënimit është rregulluar më hollësisht me dispozitat ligjore të nenit 356 të KPP-së.

fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal. Pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit dënues ka qenë njëri prej pretendimeve që është paraqitur mjaft shpesh në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe është trajtuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, andaj edhe si i tillë, është vlerësuar se është e rëndësishme që të elaborohet më hollësisht. Kjo edhe për faktin se pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit dënues ka qenë arsye për anulimin e disa aktgjykimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe kthimin e rasteve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.¹⁶

Pra, bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata duhet që në dispozitivin e aktgjykimit dënues të shënon veprën për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.¹⁷

Gjykata duhet që në aktgjykim të shënon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme veprën penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës ligjore përkatëse të KPRK-së.

Përveç kësaj, në dispozitiv të aktgjykimit duhet shënuar edhe emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit. Njëherit, këto dy (2) elemente, vepra penale, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe emërtimi ligjor i veprës penale, së bashku me dispozitat e ligjit penal, janë pjesë tejet të rëndësishme të dispozitivit të aktgjykimit.¹⁸

Emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal janë të ndërlidhura në mes vete dhe trajtohen së bashku, andaj edhe si të tilla nuk duhet të jenë në kundërshtim njëra me tjetrën. Kështu, p.sh. te vepra penale “Vrasja”, nga neni 172 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është “Vrasja”, kurse dispozita e ligjit

¹⁶ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.81-82.

¹⁷ Neni 7 i KPRK-së.

¹⁸ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.88.

penal është neni 172 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo veprë penale. Apo, te vepra penale “Vjedhja”, nga neni 313 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është “Vjedhja”, kurse dispozita e ligjit penal është neni 313 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo veprë penale.

Gjithashtu, dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshijë edhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit ose lirimin nga dënimi, si dhe vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit.¹⁹

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet që të precizojë në mënyrë të qartë llojin e dënimit të cilin ja ka shqiptuar të akuzuarit dhe kohëzgjatjen e tij apo shumën e dënimit me gjobë, duke përfshirë këtu edhe mënyrën e ekzekutimit.

Po ashtu, në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet të shënon edhe vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi, nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose television dhe urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli, ndërsa nëse është shqiptuar dënimi me gjobë, atëherë në aktgjykim, atëherë shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.²⁰

Kurse, në rastet rastet e veprave penale në bashkim,²¹ atëherë sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369 paragrafi 5 të KPP-së, në rastin e gjykimit të veprave penale

¹⁹ Llogaritja e paraburgimit, arrestit shtëpiak dhe çdo periudhe të heqjes së lirisë lidhur me veprën penale bëhet duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së. Në këtë drejtim, për qëllime të llogaritjes: një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë janë të barabartë. Ndërsa, sipas nenit 57 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, një (1) ditë paraburgim barazohet me një (1) ditë e gjysmë burgim.

²⁰ Neni 364 i KPRK-së.

²¹ Bashkimi i veprave penale ekziston atëherë kur kryesi kryen dy apo më shumë vepra penale, për të cilat në të njëjtën kohë zhvillohet procedura penale dhe për të gjitha veprat penale të kryera shqiptohet një dënim unik. Nga kjo shihet se për t’u konsideruar se ekziston bashkimi i veprave penale, duhet të përmbushen këto kushte në mënyrë kumulative: që të jenë kryer dy apo më shumë vepra penale; që këto vepra të jenë kryer nga i njëjti person dhe që për këto vepra kryesi të mos ketë qenë i dënuar më parë. Më gjerësisht lidhur me këtë temë, shih: SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, fq. 159-166.

të tilla, gjykata në dispozitivin e aktgjykimit shënon dënimet e shqiptuara për secilën veprë penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim.²²

Të gjitha këto elemente që u paraqiten më lart duhet që të shënohen në dispozitiv të aktgjykimit në mënyrë të qartë dhe kuptueshme. Përndryshe, kur dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban këto elemente, të cilat është dashur të shënohen apo në dispozitiv të aktgjykimit nuk janë shënuar dhe specifikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme këto elemente, ndërsa kjo ndikon në marrjen e një aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, atëherë një gjë e tillë paraqet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 27. lidhur me nenin me nenin 369 paragrafët 3, 4 dhe 5 të KPP-së.²³

2.3. Arsyetimi i aktgjykimit

Arsyetimi i aktgjykimit është pjesë tejet e rëndësishme e aktgjykimit dhe në të, gjykata duhet që të përfshijë arsyet mbi bazën e të cilave e ka dhënë aktgjykimin.

Në nenin 369 paragrafi 6 të KPP-së, është parashikuar se “gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”. Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, parburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera më specifike që do të paraqiten më poshtë.²⁴

Përndryshe, paraqitja e arsyeve ka të bëjë me arsyet faktike dhe juridike. Arsyetimi i anës faktike mbështetet në çmuarjen e lirë të provave, ku gjykata duhet që të analizojë çdo provë veç e veç, duke përfshirë tërësinë e tyre, raportin ndërmjet provave dhe të shprehet qartë se cilat prova dhe për çfarë arsyesh i ka pranuar ose nuk i ka pranuar.²⁵ Kurse, arsyetimi i anës juridik i referohet interpretimit dhe konkretizimit të dispozitave ligjore përkatëse.

Gjendja e vërtetuar në dispozitiv të aktgjykimit patjetër duhet të arsyetohet, duke e parashtruar procesin logjik nëpërmjet të të cilit është arritur deri te bindja e caktuar.

²² Në nenin 76 të KPRK-së janë përcaktuar rregullat për shqiptimin e dënimeve për bashkim të veprave penale.

²³ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.88-89.

²⁴ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.105.

²⁵ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar*, Prishtinë, 2014, fq. 864.

Në këtë drejtim, sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369 paragrafi 7 të KPP-së, gjykata duhet që të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë duhet të vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjykata në mënyrë të veçantë të vlerësojë:

- a) saktësinë e provave kundërthënëse,
- b) arsyet e mos miratimit të propozimit konkret të palëve dhe
- c) arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.

Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv. Posaçërisht duhet të theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre.²⁶

Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.²⁷ Në nenin 70 paragrafët 2 dhe 3 të KPRK-së, janë parashikuar rrethanat të cilat gjykata duhet t'i marrë parasysh gjatë matjes së dënimit, si rrethanat rënduese, ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Sipas këtyre dispozitave ligjore, përveç këtyre rrethanave që janë cekur në mënyrë taksative, gjykatës i është dhënë mundësia që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë që të caktohet një dënim më i rreptë apo më i butë. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethanat objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethanat subjektive, që i referohen kryesit. Me rrethana rënduese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rëndë brenda kufijve të parashikuar me ligj për atë vepër penale, ndërsa me rrethana lehtësuese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë, gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj.²⁸

²⁶ SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, fq. 396.

²⁷ Neni 369 paragrafi 8 i KPP-së.

²⁸ SHALA, AFRIM: *Hyrje në të drejtën penale*, fq. 259-260.

Të gjitha rrethanat, si rënduese, ashtu edhe ato lehtësuese, të cilat janë marrë për bazë nga gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim duhet që të paraqiten në arsyetim të aktgjykimit.

Gjithashtu, gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitues ose konfiskimin e pasurisë së fituar përmes kryerjes së veprës penale.

Sa i përket çështjes së konfiskimit, aktgjykimi duhet të përmban arsyetimin për konfiskimin e secilit send për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilin send për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi.

Në rastet kur i akuzuari lirohet nga akuza, në arsyetim veçanërisht shënohet arsyeja e paraparë në nenin 363 të KPP-së, mbi bazën e të cilit është marrë aktgjykimi lirues, kurse, në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza, gjykata nuk e vlerëson çështjen kryesore, por kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të akuzës.²⁹

3. Vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës

Edhe vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale, përveç tjerash duhet të përmbajnë edhe pjesën e arsyetimit, në të cilën pjesë duhet që të paraqiten arsye përkitazi me vendosjen e saj, me qëllim që të bindën palët, personat tjerë të interesuar dhe opinionin e gjerë për drejtshmërinë e vendosjes së çështjes nga kjo gjykatë.

Arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, qoftë i aktgjykimeve apo aktvendimeve, duhet të fokusohet, në rend të parë, në vlerësimin e pretendimeve të ankesës.³⁰ Krahas kësaj, arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të fokusohet edhe në dhënien e vlerësimeve lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore, të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Përmbajtja e arsyetimit, në masë të madhe varet edhe nga lloji i vendimit gjyqësor që është marrë.³¹

²⁹ Neni 369 paragrafët 10-11 të KPP-së.

³⁰ Në nenin 404, paragrafi 1 të KPP-së është parashikuar se “në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit të Kosovës vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare”.

³¹ HAJDARI, AZEM : Kodi i Procedurës Penale, Komentar, Prishtinë, 2016, fq. 971.

Duke u bazuar në këto që u theksuar në lart dhe në nenin 404 paragrafi 1 të KPP-së, në arsyetimin e vendimit (aktgjykimit dhe aktvendimit), Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson:

- 1) **Pretendimet e ankesës dhe**
- 2) **Shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.**

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë. Megjithatë, është e rëndësishme që të theksohet se Gjykata e Apelit e Kosovës nuk detyrohet që të shqyrtojë në hollësi çdo pohim të ankesës.³² Se në çfarë mase dhe niveli duhet që të vlerësohen pretendimet e ankesës, kjo varet nga rrethanat dhe specifikat e secilit rast veç e veç.

Duke e pasur parasysh arsyetimi i vendimeve gjyqësore duhet të trajtohet edhe nga aspekti i të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, e drejta për një proces të rregullt nga neni 6 i KEDNj-së përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) dhe e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat janë të detyruara “që t’i tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat i kanë bazuar vendimet e tyre”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm.³³

Ndërsa, **sa i përket çështjes së dytë,** Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që t’i tregon edhe shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të shqyrton detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafit 1 të KPP-së ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

³² SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 966.

³³ Rasti KII114/22 me parashtrues Valdet Dumani, aktgjykimi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i datës 24.04.2023. Gjithashtu, shih: Rastin “*Hadjianastassiou kundër Greqisë*”, aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

Arsyetimi i aktgjykimit është shumë i rëndësishëm dhe kualiteti i vendimeve gjyqësore varet nga kualiteti i arsyetimit.³⁴

Arsyetimi i aktgjykimit ju mundëson palëve, përfaqësuesve të tyre dhe publikut të gjerë që të njoftohet me arsyet se pse gjykata ka vendosur në një mënyrë të caktuar.

Rëndësia e arsyetimit shihet edhe nga fakti se mos hartimi i aktgjykimit me dispozitat ligjore që i referohen arsyetimit të aktgjykimit, nga neni 369 paragrafët 1 dhe 6-11 të KPP-së paraqet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, e cila shkelje në shumë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës ka qenë arsye për anulimin e aktgjykimeve dhe kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyetimi i aktgjykimit duhet shikuar edhe si detyrë të gjykatës që buron nga dispozitat ligjore të brendshme, por nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, siç do të elabrohet edhe në vijim të këtij punimi.

GjEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se “vendimet e gjykatave duhet të paraqesin në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato janë bazuar”.

Njëkohësisht, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, çështjen e arsyetimit të vendimit gjyqësor duhet shikuar edhe nga aspekti i të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor i përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNj-së.

Tani arsyetimi i vendimeve gjyqësore përbën një standard në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt, sipas së cilit interesat e drejtësisë nuk mund të arrihen nëse vendimi gjyqësor nuk është i arsyetuar.

Detyrimi për të paraqitur arsye në një vendim gjyqësor siguron të drejtën për një proces transparent dhe siguron publikun që vendimi gjyqësor nuk është arbitrar dhe është në harmoni me parimet kushtetuese dhe ligjore.

Gjithashtu, vendimet gjyqësore të arsyetura i shërbejnë qëllimit për t'u demonstruar palëve se janë dëgjuar, si dhe i detyrojnë gjyqtarët që arsyetimet e tyre t'i bazojnë në argumente objektive. Vendimi gjyqësor i arsyetuar është i rëndësishëm edhe për faktin se përmes tij i mundësohet çdo personi që ta shfrytëzojë të drejtën në ankesë, duke ju referuar edhe arsyeve që janë paraqitur në atë vendim.

³⁴ SHALA, AFRIM: *Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë*, “Përmbledhje nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile”, fq.107.

Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishme në çdo argument.

Vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.³⁵ Ndërsa, janë argumentet thelbësore të palëve që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.³⁶

4. Metoda “IRAC”

Në disa shtete, me rastin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore zbatohet metoda e ashtuquajtur “IRAC”. Gjyqtarët gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore, përmes kësaj metode, i strukturojnë, organizojnë dhe i trajtojnë çështjet, si ligjore, ashtu edhe faktike, duke përdorur një metodologji dhe analizë e cila kalon nëpër disa etapa apo faza.

IRAC është një shkurtesë e fjalëve “**Issue, Rule, Application, Conclusion**”, që në gjuhën shqipe përkthehet “**Çështja/Problemi, Rregullat/Dispozitat, Aplikimi/Zbatimi dhe Konkuzioni/Përfundimi**”.

Një metodë e tillë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore përdoret edhe në disa gjykata ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe GjEDNj-në, si dhe nga disa gjykata kushtetuese të shteteve të ndryshme.³⁷

Sipas kësaj metode, procesi i të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore, në parim, kalon nëpër këto katër (4) etapa apo hapa:

- ✓ **Së pari**, duhet që të identifikohet çështja apo problemi që duhet të adresohet dhe zgjidhet;
- ✓ **Së dyti**, duhet që të identifikohen rregullat apo dispozitat ligjore (kushtetuese) që janë të rëndësishme zgjidhjen e çështjes apo problemit;

³⁵ Rasti “*Hadjianastassiou kundër Greqisë*”, aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

³⁶ Rasti “*Hiro Balani kundër Spanjës*”, aktgjykimi i datës 09.12.1994, paragrafi 27; Rasti “*Van de Hurk kundër Holandës*”, aktgjykimi i datës 19.04.1994, paragrafi 61; Rasti “*Higgins dhe të tjerët kundër Francës*”, aktgjykimi i datës 19.02.1998, paragrafi 42, etj.

³⁷ Në përgjithësi, kjo metodë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore zbatohet edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. <https://gjk-ks.org/vendimet/>

- ✓ **Së treti**, duhet që të analizohet dhe përcaktohet nëse elementet e rregullave, përkatësisht dispozitave ligjore aplikohen ndaj fakteve të çështjes përkatëse gjyqësore dhe
- ✓ **Së katërti**, duhet të paraqiten konkluzionet apo përfundimet në lidhje me aspektet e vendimmarrjes në çështjen e caktuar gjyqësore.

5. Komete përmbledhëse

Në nenin 369 të KPP-së është përcaktuar përmbajtja dhe forma e aktgjykimit, të cilin dispozitë ligjore duhet ta kenë në konsideratë gjyqtarët gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, pasi që mos hartimi i aktgjykimit sipas këtyre dispozitave ligjore, përbën edhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshin të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 369 paragrafët 3-5 dhe në nenin 364 të KPP-së. Në veçanti, gjyqtarët me rastin e shqyrtimit të rasteve, si dhe marrjes dhe hartimit me shkrim të aktgjykimeve duhet t'i kushtojnë rëndësi elementit të parashikuar në nenin 364 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 të KPP-së, që ka të bëjë me veprën penale për të cilën shpallet fajtor i pandehuri, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK. Siç është theksuar edhe më parë, ky element i dispozitivit të aktgjykimit ka qenë arsye që në disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës janë anuluar aktgjykimet e instancave më të ulta.

Gjithashtu, një pjesë shumë e rëndësishme e aktgjykimit është edhe arsyetimi. Siç është theksuar edhe më parë, në nenin 369 paragrafi 6 të KPP-së, është parashikuar se “gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”. Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera të rëndësishme.

Gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjyqtarët në mënyrë të veçantë të vlerësojnë:

- a) saktësinë e provave kundërthënëse,
- b) arsye e mos miratimit të propozimit konkret të palëve dhe
- c) arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.

Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv, andaj edhe një aspekt i tillë duhet të jetë në vëmendjen e posaçme të gjyqtarëve gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit. Posaçërisht duhet të

theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre, pa bërë një vlerësim dhe analizim të provave. Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Gjithashtu, pjesë përbërëse e aktgjykimit duhet të jetë edhe “Udhëzimi për të drejtën në ankesë”, sipas nenit 369 paragrafët 5 dhe 6 dhe nenin 473 paragrafi 3 të KPP-së. Udhëzimi për të drejtën në ankesë përmban këshilla juridike se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, nga palët dhe personat tjerë të autorizuar, sipas nenit 381 të KPP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes aktgjykimit. Ankesa duhet që t’i dorëzohet gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.

LITERATURA, AKTE JURIDIKE DHE RASTE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE

I. Libra dhe botime tjera

- HAJDARI, AZEM: *E drejta e procedurës penale*, Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2013.
E drejta e procedurës penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2014.
Kodi i Procedurës Penale, Komentar, Prishtinë, 2016.
- KELMENDI,
BESIM;
IBRAHIMI, HAMDI: *Format e shkresave në procedurat penale*, Prishtinë, 2017.
- ISLAMI, HALIM;
HOXHA, ARTAN;
PANDA, ILIR: *Procedura penale*, Komentar, Tiranë, 2003.
- SAHITI, EJUP;
MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016.
- SAHITI, EJUP;
MURATI, REXHEP;
ELSHANI,
XHEVDET: *Kodi i Procedurës Penale*, Komentar, Prishtinë, 2013.
- SHALA, AFRIM: *Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2010.
Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.
Doracaku për procedurë penale, Prishtinë, 2015, (bashkautor).
Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike “Opinio Juris”, Akademia e Drejtësisë, Viti II, nr.2, Prishtinë, 2016.
Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, Prishtinë, 2021, (bashkautor).
Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023.
Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në Çështjet penale dhe civile, Prishtinë, 2023 (kontribuues).³⁸
Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë, 2023, (kontribuues).³⁹
Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale, Tiranë, 2023.
- SHALA, AFRIM;
ADEMI, BURIM;
KUQI, RAMIZ: *Drejtësia Mjedisore*, Prishtinë, 2024.

³⁸ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PermbledhjaII_GJSshq_.pdf

³⁹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/Vendime_perzgjedhura_GJS_ADshq_.pdf

II. Akte juridike (vendore dhe ndërkombëtare)

Kodi Procedurës Penale;

Kushtetuta e Kosovës, datë 09.04.2008;

Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Këshilli i Evropës, 1950;

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, datë 10.12.1948;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, datë 02.09.1990;

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, datë 16.12.1966.

III. Praktika gjyqësore

Rastet nga praktika gjyqësore të cilat janë paraqitur në këtë punim.